



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2025, miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-08994-0 në Zonën Kadastrale Rahovec

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, me Nr. Prot. 02/5565/25, i datës 08.04.2025 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510057-08994-0** në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 12m² (dymbëdhjetë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 461m² (katërqind e gjashtëdhjetë e një metra katror) në vendin e quajtur R.SADIKU-R.SADIKU, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Salih (Sylejman) Haxhijahës.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë: "Zgjerimi i rrugës publike 'Halil Hamza-1433-0'".
3. Autorizohet kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në librin kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L/284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.24/2024 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01Nr.44/25

Datë:29.04.2025

